Vendim nr. 306, datë 28.09.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja,Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sandër Beci, anëtarë, në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (Sh) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA "SBM PROCESSING" SH.P.K.,** përfaqësuar nga administratori Avgon Cenalla dhe avokatja Valbona Otobashi, me autorizim.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 846 akti, datë 26.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 653, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-4023, datë 13.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, pika 1, 43, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", dhe 135, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese *(Mbledhja e Gjyqtarëve)*, pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Midis shoqërisë "V." sh.p.k., me objekt veprimtarie ndërtime civile etj., dhe kërkueses janë lidhur disa kontrata, në bazë të të cilave shoqëria "V." sh.p.k. ka kryer shërbimet e transportit dhe të furnizimit në bazë të termave dhe kushteve të sanksionuara në marrëveshjen e përcaktuar si "Moratorium i Marrëveshjes" *(marrëveshja)* lidhur mes palëve. Shoqëria "V." sh.p.k. ka kryer të gjitha shërbimet dhe detyrimet e saj kontraktuale sipas objektit të kontratës dhe afateve të përcaktuara nga palët dhe, bazuar në faturat përkatëse, kërkuesja duhet të kryente pagesa brenda një periudhe 30-ditore nga dita e miratimit të deklaratës mujore të punimeve (në datën 5 të çdo muaji), sipas përcaktimeve të nenit 12 të marrëveshjes.

2. Shoqëria "V." sh.p.k. pretendon se për periudhën kohore 01.06.2013 - 29.06.2014 nuk është bërë likuidimi i detyrimit kontraktual, i cili, në bazë të ekspertimit kontabël, rezulton në një vlerë të konsiderueshme. Me anë të njoftimit, datë 10.04.2015, shoqëria "V." sh.p.k. i është drejtuar kërkueses për shlyerjen vullnetare të detyrimit të palikuiduar. Me anë të shkresës nr.19 prot., datë 15.04.2015 të kërkueses palët kanë kërkuar caktimin e një takimi për rakordim, takim ky që është shtyrë vazhdimisht duke mos u konkluduar, ndërkohë që kërkuesja ka pranuar një pjesë të detyrimit monetar ndaj shoqërisë "V." sh.p.k., ndërsa konteston pjesën tjetër të saj.

3. Në këto kushte, në datën 08.09.2015, shoqëria "V." sh.p.k. i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, duke paditur kërkuesen, me objekt pagesën e detyrimit kontraktual, pagesën e shpërblimit të dëmit, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestro konservative për llogaritë bankare të kërkueses, si dhe për çdo aset tjetër të saj në shumën 36.164.588 lekë. Kjo kërkesë e shoqërisë "V." sh.p.k. është rrëzuar në datën 22.09.2015 nga ajo gjykatë.

4. Në vijim, pas ndryshimit të gjyqtarit që gjykonte çështjen e themelit, në datën 05.07.2017 shoqëria "V." sh.p.k. i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për marrjen e sigurimit të padisë në vlerën 40.928.977 lekë, duke sjellë si arsye informacionet e marra që kërkuesja kishte shitur pajisjet, ndërkohë që ndaj saj kishte edhe masa të tjera sekuestroje për asetet nga shoqëri të ndryshme përmbarimore.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 846 akti, datë 26.07.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur sekuestro konservative për llogaritë bankare të kërkueses në të gjitha bankat e nivelit të dytë, si dhe sekuestro konservative për çdo aset tjetër financiar, sende të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të shoqërisë, administratorit dhe/ose ortakëve të saj, në shumën 20.000.000 lekë si detyrim kontraktual, me qëllim garantimin e pagimit të detyrimit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ajo gjykatë ka vlerësuar se nga analiza e provave të

administruara deri në atë fazë të hetimit gjyqësor rezultonte se përmbusheshin të gjitha kriteret determinante procedurale që diktonin nevojën e sigurimit të padisë. Për sa i përket vlerës së detyrimit, për të cilën është kërkuar vendosja e sekuestros, gjykata nuk e ka pranuar tërësisht, por vetëm vlerën për të cilën edhe kërkuesja nuk ka pasur kontestime dhe që e ka pranuar si detyrim, ndërsa për pjesën tjetër gjykata nuk ka krijuar bindjen për ekzistencën e këtij detyrimi në kushtet kur gjykimi i themelit ka të bëjë pikërisht me kontestimin e kësaj vlere. Mbi këtë vendim ka paraqitur ankim kërkuesja.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 653, datë 08.05.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 846 akti, datë 26.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ajo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka arsyetuar se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e palës paditëse (shoqëria "V." sh.p.k.) do të bëhej tejet i vështirë në rast të mosvendosjes së një mase sigurimi, si rezultat i tjetërsimit të pasurisë së regjistruar në emër të kërkueses. Në këtë eventualitet, arsyeton ajo gjykatë, do të kishte pasoja të rënda që do të vështirësonin ekzekutimin e vendimit të themelit, ose do ta bënin atë të paekzekutueshëm, nëse do të pranohej padia e paditëses për çështjen e themelit.

7. Ndërkohë, gjykata e shkallës së parë, në gjykimin e çështjes në themel, me vendimin nr. 5703, datë 22.07.2018, ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë "V." sh.p.k., duke detyruar kërkuesen t'i paguajë detyrimin kontraktual në shumën 40.928.977 lekë, si dhe kamatëvonesat në shumën 6.983.128 lekë, duke ligjëruar masën e sigurimit të padisë.

8. Për rekursin e kërkueses, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-4023, datë 13.11.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile *(KPC)*. Ai kolegj ka arsyetuar se vendosja e masës së sigurimit të padisë ka ardhur si pasojë e vlerësimit nga gjykatat e faktit të atyre rrethanave që evidentojnë "dyshimet e arsyeshme për pamundësinë ose vështirësinë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për të drejtat e paditësit". Këto rrethana, arsyeton Kolegji Civil, vlerësohen rast pas rasti, në varësi të kritereve të mësipërme, por edhe të gjendjes ekonomike të palës tjetër.

9. Në datën 29.05.2026 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, në datën 31.07.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkueses

10. ***Kërkuesja,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

10.1. *Cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor*, pasi:

10.1.1. Gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me ligjin procedural, ka pranuar kërkesën e veçantë për marrjen e masës së sigurimit, ndërkohë që paditësja e kishte paraqitur edhe më parë si pikë të kërkesëpadisë. Nëse pala kishte objeksione për këtë pikë duhej t'i referohej nenit 158 të KPC-së, që parashikon ndryshimin, shtimin, pakësimin ose saktësimin e objektit, ose të shkakut të padisë gjatë fazave të ndryshme të procesit. Nëse krijoheshin dyshime për kryerje të veprimeve që e pamundësonin ekzekutimin, vendimi mund të merrej me emergjencë, brenda 5 ditëve dhe jo pas 2 vjetësh, si në rastin konkret.

10.1.2. Gjykata e shkallës së parë, kërkesën për marrjen e masës së sigurimit, datë 05.07.2017, e ka gjykuar si proces civil më vete, ndërkohë që ajo duhet të ishte pjesë e procesit të gjykimit të padisë së themelit. Kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë mund të gjykohet si proces civil më vete, vetëm nëse, referuar nenit 204 te KPC-së, mund të paraqitet përpara ngritjes së padisë së themelit.

10.1.3. Gjykata e shkallës së parë ka thirrur si person të tretë kërkuesen dhe me këtë cilësi ka pranuar kërkesën duke vendosur detyrime ndaj saj si person i tretë, ndërkohë që, referuar nenit 192 të KPC-së, thirrja e personit të tretë mund të kryhet derisa nuk është nxjerrë urdhri për caktimin e seancës gjyqësore. Për më tepër që kërkuesja gëzonte pozitën procedurale të palës së paditur në padinë e themelit. Edhe vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë për vendosje të masës së sigurimit të padisë në vlerën 20.000.000 lekë nuk përputhet as me kërkesën, as me padinë e themelit.

10.1.4. Edhe gjykata e apelit edhe Kolegji Civil, megjithëse nga kërkuesja ishin parashtruar një tërësi shkeljesh të ligjit procedural, nuk i kanë korrigjuar këto shkelje pa i arsyetuar vendimet e tyre, duke dhënë vendime të parregullta në cenim të pronës së saj.

10.2. *Cenimin e parimit të proporcionalitetit në lidhje me të drejtën e pronës,* pasi kufizimet e të drejtave pronësore, si në rastin e saj, duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar ato, ndërkohë që bllokimi i një vlere prej 20.000.000 lekësh është disproporcional, në kushtet kur vijon për një kohëzgjatje prej 10 vjetësh.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

11. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Për sa u takon kritereve kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kritereve të pranueshmërisë së kërkesës, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kritereve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare *(shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve)*.

13. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së pronës dhe së drejtës për proces të rregullt ligjor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues. Duke mbajtur në konsideratë se argumenti themelor i kërkueses lidhet me bllokimin e një shume parash, si pasojë e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon t'i analizojë pretendimet e saj në këndvështrim të së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesja nuk kundërshton ligjshmërinë e ndërhyrjes në të drejtën e pronës dhe as ekzistencën e një interesi publik që e justifikon atë, por pretendon vetëm se kjo ndërhyrje është joproporcionale. Për rrjedhojë, analiza kushtetuese do të përqendrohet në vlerësimin e respektimit të parimit të proporcionalitetit, konkretisht nëse bllokimi i shumës së parave, në rrethanat e çështjes

konkrete, ka vendosur mbi kërkuesen një barrë të tepruar, duke cenuar ekuilibrin e drejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes të së drejtës së pronës.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e pronës

14. Kërkuesja ka pretenduar se kufizimet e të drejtave pronësore, si në rastin e saj, duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar ato, ndërkohë që bllokimi i një vlere prej 20.000.000 lekësh është disproporcional, në kushtet kur vijon për një kohëzgjatje prej 10 vjetësh.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se neni 41, pika 3, i Kushtetutës lejon kufizimin në të drejtën e pronës, por kufizimi, sipas nenit 17, pika 2, të saj, duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

16. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet të cilave u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit. Në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre *(shih vendimet nr. 21, datë 18.04.2023; nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, date 20.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Gjykata ka theksuar se ndërhyrja që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës duhet: të jetë e ligjshme, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik; të vendosë një "ekuilibër të drejtë" midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës; të respektojë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm *(shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Edhe pse këto masa kufizuese gjejnë mbështetje kushtetuese (nenet 41 dhe 17 të Kushtetutës), pasi synojnë realizimin e një interesi publik, në mënyrë që dëmi në të drejtat individuale të jetë në përputhje me garancitë kushtetuese, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme *(shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis sekuestros dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata merr në analizë, në linjë me praktikën e saj, disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së sekuestros, në kuptim të balancimit të të drejtave ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes të të drejtave themelore të individit, në këtë rast shoqëri tregtare. Për këtë qëllim, ajo ndalet në vlerësimin e nevojës, të përshtatshmërisë dhe të ashpërsisë së masës së sekuestros, duke mbajtur në konsideratë shpejtësinë e procedurave, pra që ndërhyrja në njërin prej tagrave të së drejtës së pronës (në rastin konkret gëzimi dhe disponimi i saj) të zgjasë për një kohë të kufizuar, si dhe dëmin që vjen nga cenimi, i cili nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme *(shih vendimin nr. 79, datë 12.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ndërkohë, sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme *(shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Për sa i takon sekuestros, ajo është një masë sigurimi pasuror me karakter të përkohshëm në të drejtën civile, e cila vendoset mbi pasuritë e një debitori ose të pandehuri për të parandaluar tjetërsimin, fshehjen ose dëmtimin e tyre, derisa të jepet një vendim përfundimtar nga gjykatat. Qëllimi i saj është për të garantuar që kreditori ose pala e dëmtuar të ketë ende një pasuri ku të ekzekutojë vendimin përfundimtar, ndërsa ka karakter të përkohshëm dhe mund të vendoset mbi sende të luajtshme, të paluajtshme, llogari bankare ose kuota shoqërish tregtare.

20. Nën dritën e garancive të mësipërme, si dhe duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkueses, Mbledhja e Gjyqtarëve, mbështetur tek arsyetimi i gjykatave të zakonshme, do të vlerësojë në vijim nëse në rastin konkret vendosja e masës së sekuestros konservative ka respektuar parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në kufizimin e së drejtës së pronës në drejtim të kohështrirjes së saj.

21. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në arsyetimin e vendimit të saj ka vlerësuar se sigurimi i objektit të padisë nuk lidhet me një kërkim civil të hamendësuar nga paditësja, por të bazuar në prova fillestare, vlerësimi i të cilave do t'i përkiste përfundimit të gjykimit dhe vendimmarrjes gjyqësore në raport me mosmarrëveshjen mes palëve. Më tej, ajo gjykatë ka vlerësuar se mbajtja përkohësisht "e ngrirë" e gjendjes juridike të pronësisë për pasuritë e kërkueses përmes vendosjes së sekuestros për bankat e nivelit të dytë përbën një garanci për gjyqfituesin se e drejta e fituar përmes procesit gjyqësor mund të përfitohet efektivisht në fazën e ekzekutimit. Në të kundërtën e këtij konkluzioni, ka arsyetuar ajo, mosveprimi i gjykatës për sigurimin e së drejtës objekt gjykimi do të ekspozonte paditësen ndaj situatës së mosgjetjes të pasurive të debitorit për shlyerjen e detyrimit, për shkak të mundësisë potenciale të tjetërsimit

të saj. Sipas saj, rreziku bëhej më evident duke marrë në konsideratë faktin se kërkuesja ndodhej prej disa vitesh në pamundësi të pagimit të detyrimit të mbetur, për më tepër që kryerja e veprimeve të tilla, si krijimi i një shoqërie tjetër nga ana e saj, ose shitja e të gjitha aseteve, mund ta vështirësonte këtë shlyerje, prandaj mosmarrja e masave për bllokimin e llogarive bankare mund të thellonte gjendjen e tyre të insolvabilitetit. Për sa i përket vlerës së detyrimit, për të cilën është kërkuar vendosja e sekuestros, ajo gjykatë nuk e ka pranuar tërësisht, por vetëm vlerën për të cilën edhe kërkuesja nuk ka pasur kontestime, dhe që e ka pranuar si detyrim.

22. Gjykata e Apelit Tiranë, në marrjen e vendimit, ka arsyetuar, ndër të tjera, se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar në përputhje me kërkesat e normave procedurale duke kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me ligjin, sipas parashikimeve të nenit 14 të KPC-së, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të palëve. Në rastin konkret, pohon ajo, pala paditëse ka paraqitur përpara gjykatës së shkallës së parë disa dokumente shkresore, me anë të të cilave pretendon se llogaritë në pronësi të personit të tretë, nëse do të transferoheshin prej kësaj pale, do të sillnin një dëm të rëndë dhe të pazëvendësueshëm nga ana financiare për të. Ndaj, në kushtet kur, sipas paditëses, ende nuk ishte provuar sesa ishte vlera e detyrimit mbetur e palikuiduar, në një kohë që sipas pretendimeve të saj kjo vlerë ishte dy herë më e madhe sesa vlera e sekuestruar në llogaritë e kërkueses, si dhe mbështetur në faktin që kjo pasuri ishte regjistruar në emër të saj, përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë ishte i drejtë. Për sa i përket llojit të masës së sigurimit të objektit të padisë, ajo gjykatë ka vlerësuar se masa e caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e përshtatshme për të krijuar garancitë e nevojshme për ruajtjen e një gjendjeje pezull në konfliktin juridik midis palëve në marrëdhënien procedurale të njohjes të së drejtës së pagimit të detyrimit kontraktor, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësisht të pretendimeve të palëve.

23. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se në rekursin e paraqitur nga kërkuesja nuk konstatohet asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Sipas tij, konkluzionet e arritura nga gjykatat e faktit janë rrjedhojë e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes në zbatim të ligjit, duke bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen. Vendimi për sigurimin e padisë nuk bie ndesh me parashikimet e neneve 202 e vijues të KPC-së, ku, sipas këtyre dispozitave, sigurimi i padisë lejohet të vendoset edhe në mungesë të një garancie për dëmin e mundshëm që mund t'i vijë palës së paditur ndaj së cilës urdhërohet masa. Një gjë e tillë del qartë jo vetëm nga karakteri numërtues i rasteve kur vendoset masa e sigurimit sipas nenit 20, pika 2, të KPC-së, por edhe nga parashikimi i nenit 202, pika 3, të dispozitës, sipas së cilës kërkimi i garancisë për rastin e

masës së sigurimit të vendosur sipas pikës 2, shkronja "b", përbën një mundësi dhe jo një detyrim, për rrjedhojë kërkimi i saj ose jo mbetet në diskrecionin e gjykatës nisur nga natyra e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, niveli i bazueshmërisë së provave në mbështetje të kërkimit, kohëzgjatja e mosmarrëveshjes së palëve, serioziteti e korrektësia e palëve në përmbushjen e detyrimeve të mëparshme kontraktore midis njëra-tjetrës, masa e detyrimit, duke mos përbërë shkelje të ligjit procedural. Si konkluzion, vendimet e gjykatave të faktit janë të drejta dhe vijnë si pasojë e vlerësimit nga ato, të atyre rrethanave që evidentojnë dyshimet e arsyeshme për pamundësinë ose vështirësinë e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për të drejtat e paditëses.

24. Sikurse u theksua më lart, masa e sigurimit të padisë është vendosur në datën 26.07.2017. Për sa i takon kohëzgjatjes së masës, duke mbajtur në konsideratë objektin e ankimit kushtetues, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit të padisë, parimin e subsidiaritetit dhe mjetet juridike që kërkuesi ka në dispozicion, si dhe bazuar në jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me masat e sigurimit personal (*shih vendimin nr. 7, datë 20.02.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), për aq sa ajo zbatohet *mutatis mutandis* edhe për masat e sigurimit të padisë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se momenti faktik kohor që duhet të merret në konsideratë lidhet me momentin kur ajo masë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar nga caktimi i masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues. Për më tepër, rezulton se gjatë pjesës dërrmuese të periudhës kur rekursi kundër masës së sigurimit qëndronte i pashqyrtuar në Gjykatën e Lartë, procesi i themelit kishte ecur përpara, duke pasur tashmë edhe një vendim pranimi të padisë, duke ligjëruar edhe masën e sigurimit të padisë. Kjo do të thotë se pas këtij momenti, masa e sigurimit prej 20.000.000 lekësh nuk garanton më vetëm një pretendim të paprovuar kontraktor, por një detyrim që të paktën një gjykatë e themelit e ka njohur me vendim.

25. Po kështu, në analizë të proporcionalitetit të masës, rezulton se kërkuesja nuk ka arritur të individualizojë dëmin që pretendon se ka ardhur nga masa objekt i ankimit kushtetues individual, pra se "zvogëlimi i aktivitetit" të pretenduar ka ardhur pikërisht për shkak të kësaj mase dhe jo nga ndonjë masë tjetër. Në këtë kuptim, kërkuesja nuk ka arritur të tregojë jo vetëm dëmin, por edhe lidhjen shkakësore me masën e kundërshtuar në Gjykatë, kjo edhe për faktin se efektet e masës nuk mund t'i atribuohen pa një analizë vendimit të ndërmjetëm të vitit 2017.

26. Gjithashtu, gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm edhe për elemente të tjera që lidhen me vendosjen e masës duke e vënë theksin te nevoja e vendosjes së saj pikërisht për garantimin e mostjetërsimit të aseteve financiare dhe atyre fizike të kërkueses, me qëllim shmangien nga detyrimi në një eventualitet të pranimit të padisë. Po kështu, gjykatat e

zakonshme kanë arsyetuar se ekzistonte një dyshim i arsyeshëm se pasuria objekt sekuestroje mund të tjetërsohej nga kërkuesja, çka e bënte të nevojshme vendosjen e masës së sekuestros.

27. Si konkluzion, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se edhe pse kufizimi ka prekur tagrat e pronësisë, duket se midis kufizimit të vendosur dhe qëllimit të ndjekur ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, në kuptim të kohëzgjatjes së masës, prandaj kufizimi i së drejtës së pronës është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë, detyrimet e papaguara ndaj paditëses. Në këtë kuptim, në situatën reale dhe faktike gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm lidhur me proporcionalitetin e masës së sekuestros, duke arritur në konkluzionin se masa e vendosur ishte proporcionale.

28. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se përfundimi i gjykatave të zakonshme që masa e kundërshtuar është vendosur sipas ligjit dhe që është proporcionale, nuk është i paarsyeshëm ose arbitrar. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së proporcionalitetit të masës së sekuestros është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesja, shoqëria "SBM Processing" sh.p.k., me objekt *"Shfuqizimi i vendimeve nr. 846 akti, datë 26.07.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 653, datë 08.05.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-4023, datë 13.11.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë",* jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara, pasi vlerësoj se çështja duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare për sa i takon pretendimit për proporcionalitetin e masës të lidhur me të drejtën e pronës në drejtim të kohëzgjatjes së saj, në këndvështrim të neneve 17 dhe 41 të Kushtetutës, me argumentet e mëposhtëm.

2. Ndonëse bashkohem me vlerësimin e shumicës se kërkuesja ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës së pronës dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të cilat *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues (*shih paragrafin 13 të vendimit*), ndahem prej mënyrës së vlerësimit të kritereve paraprake të legjitimimit të kryer nga shumica, sepse ajo ka arritur në përfundimin se kërkuesja nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimi kryesor i saj për cenimin e parimit të proporcionalitetit në lidhje me të drejtën e pronës është haptazi i pabazuar.

3. Pa diskutim që qëllimi i vendosjes së një mase sigurimi padie është mbajtja përkohësisht "*e ngrirë*" e gjendjes juridike të pronësisë mbi pasuritë e kërkueses përmes vendosjes së sekuestros si një garanci për gjyqfituesin, me qëllim që një e drejtë që do të fitohet potencialisht përmes procesit gjyqësor, të mund të përfitohet edhe efektivisht në fazën e ekzekutimit. Në linjën e analizës së mëtejshme të qëllimit të masës së sekuestros që synon shmangien e situatës së mosgjetjes së pasurive të debitorit për shlyerjen e detyrimit, vlerësoj se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të mbajnë në vëmendje që vendosja e kësaj mase ka dhe duhet të ketë karakter të përkohshëm në të drejtën civile, gjë që e pranon edhe shumica (*shih paragrafin 19 të vendimit*).

4. Pikërisht te kohëzgjatja faktike e kësaj "*përkohshmërie*" të vazhdimit të masës së sigurimit të vendosur nga gjykata e shkallës së parë jam ndarë nga vlerësimi dhe vendimmarrja e shumicës. Në referencë edhe të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, rezulton se masa e sigurimit të padisë është vendosur në datën 26.07.2017, pra përpara rreth 9 vjetësh, për një detyrim prej 20.000.000 lekësh, vendim ky që është lënë në fuqi si i drejtë nga dy gjykatat më të larta. Shumica nuk e vlerëson kohëzgjatjen si element që duhet të merret në konsideratë në rastet e kufizimit të së drejtës së pronës, sepse arsyeton se "... *momenti faktik kohor që duhet të merret në konsideratë lidhet me momentin kur ajo masë është vlerësuar nga*

gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar nga caktimi i masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues". Ndahem nga shumica në këtë pikë, sepse pa diskutim që momenti i caktimit të masës është i rëndësishëm, sepse në këtë moment vlerësohet nga gjykata përkatëse e juridiksionit të zakonshëm nevoja dhe domosdoshmëria nëse do të vendoset ose jo masa e sigurimit dhe qëllimi për të cilin ajo vendoset. Në këtë mënyrë kjo gjë e lidh çështjen me datën 26.07.2017, data kur është vendosur masa e sigurimit të padisë me vendim të gjykatës së shkallës së parë. Megjithatë, procesi që ankimohet në gjykimin kushtetues lidhet me gjithë zinxhirin e vendimmarrjeve nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë, përkatësisht në vitet 2018 dhe 2025, me objekt heqjen e masës së sigurimit të padisë.

5. Për sa më sipër, mendoj që kohëzgjatja e masës për 9 vjet përbën në vetvete një bllokim të aseteve dhe llogarive bankare të kërkuesit, gjë që ndonëse mund të ketë qenë e nevojshme për të garantuar shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, e kombinuar me një kohëzgjatje në vite, ka gjasa të krijojë vështirësi ekonomike dhe të rrisë rrezikun potencial të një gjendje insolvabiliteti për debitorin.

6. Gjykimi i çështjes së themelit (që lidhet me përmbushjen e detyrimeve kontraktore) me ritme tepër të ngadalta, pavarësisht shkaqeve objektive me të cilat përballet sistemi i drejtësisë, bën që praktikisht e drejta e pronës të cenohet në mënyrë indirekte për debitorin, i cili nëse do të qarkullonte shumën e bllokuar në veprimtarinë tregtare të tij ose do të përdorte asetet e tij (mjete, pajisje ose materiale, që nuk janë specifikuar në vendimin e gjykatës për dhënien e masës së sigurimit), do të kishte mundësi të shtonte kufijtë e të ardhurave të tij për të përballuar më mirë detyrimin ndaj kreditorit. Fakti që çështja e themelit është ende në gjykim (sepse ka mbaruar vetëm gjykimi në shkallë të parë dhe fati i gjykimit do të vlerësohet në të ardhmen), bën që kohëzgjatja e masës së sigurimit të padisë të vijojë të mbetet në fuqi e pasigurt se kur do të përfundojë.

7. Fakti që procesi gjyqësor që kundërshton kërkuesi lidhet me masën e sekuestros për sigurimin e padisë, objekt i këtij gjykimi kushtetues, tregon që debitori e ka përdorur mjetin procedural të parashikuar nga neni 207 i KPC-së për të kërkuar heqjen ose zvogëlimin e kësaj mase në rrugë gjyqësore dhe gjendja për të vazhdon të mbetet e pandryshueshme, ndonëse formalisht mjeti mund të ripërdoret përsëri në të ardhmen, ndërkohë afatet e kohëzgjatjes ecin dhe pasuria dhe asetet vijojnë të jenë "*të ngrira*". Ndaj, në mënyrë parimore, vlerësoj se një kohëzgjatje e paarsyeshme dhe e pabalancuar e një mase sekuestroje që ka bllokuar llogaritë bankare përbën një vendim të ndërmjetëm që duhet të përfshihet në juridiksionin kushtetues, sepse ka pasoja të drejtpërdrejta mbi të drejtën e pronës.

8. Në këtë kuptim, ndonëse mendoj se masa e sekuestros mund të jetë e nevojshme dhe e dobishme për vendosjen në vend të drejtësisë dhe të së drejtës, gjykatat e zakonshme në

rastin e vendosjes së masave të tilla duhet të bëjnë përpjekje që procesi gjyqësor i themelit të gjykohet me prioritet dhe të zhvillohet me ritme më të shpejta për të shmangur pasojat rënduese që krijojnë vonesa të tilla, të cilat, për hir të së vërtetës, rëndojnë mbi të dyja palët, edhe mbi debitorin, edhe mbi kreditorin.

9. Ky arsyetim vjen në të njëjtën linjë me mendimin paralel që kam shprehur më parë në çështjen me kërkuese *shoqërinë tregtare "Kostur Krom" sh.p.k. (shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese)*, ku kam parashtruar se një vendim i ndërmjetëm që lidhet me masat e sigurimit të padisë do të jetë pjesë e një shqyrtimi kushtetues kur "… *pasojat e masës së sekuestros do të kishin qenë aq rënduese për një subjekt tregtar, sa që të kombinuara edhe me tejzgjatjen e vazhdimësisë së masës do të sillnin si pasojë riskun e një falimentimi të mundshëm*" dhe rasti konkret, objekt i këtij gjykimi kushtetues, lidhet pikërisht me një situatë të tillë.

10. Në vijim të analizës sime si gjyqtare në pakicë, ndërsa pajtohem me shumicën për pabazueshmërinë e pretendimeve të kërkueses për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndahem me qëndrimin e shumicës lidhur me analizën e proporcionalitetit në drejtim të kohëzgjatjes së masës së sigurimit të padisë. Më konkretisht, lidhur me arsyetimin e shumicës se "*... midis kufizimit të vendosur dhe qëllimit të ndjekur ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti në kuptim të kohëzgjatjes së masës, prandaj kufizimi i së drejtës së pronës është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë, detyrimet e papaguara ndaj paditëses* (*shih paragrafin 27 të vendimit*), vlerësoj se proporcionaliteti nuk është analizuar mjaftueshëm nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Pavarësisht se në vitin 2018 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është shprehur për themelin, duke i dhënë të drejtë paditëses, sërish koha e kaluar deri në këtë moment, prej gati 9 vjetësh e tejkalon elementin e ashpërsisë së masës. Në këtë kontekst, këtë qasje timen e bazoj në faktin se koha e gjatë e masës së sigurimit për një vlerë të konsiderueshme të aseteve, në kushtet kur çështja e themelit nuk rezulton të jetë zgjidhur ende, është e tepruar dhe rënduese, duke sjellë cenimin e thelbit të së drejtës substanciale të pronës.

11. Veç kësaj, madhësia dhe kufijtë e aseteve të vendosura nën masë sigurimi prej 20.000.000,00 lekësh janë analizuar në drejtim të detyrimit të papërmbushur, por nuk janë analizuar mjaftueshëm nga gjykatat e juridiksionit në raport me mundësitë, likuiditetet dhe mjetet financiare që i mbeten në dispozicion debitorit përtej vlerës së masës së sekuestros për të shmangur shtyrjen drejt një procedure falimentimi të detyruar ose të paevitueshme. Në eventualitetin që nga kjo analizë do të rezultonte që kërkuesja do të kishte mjete financiare dhe asete të mjaftueshme dhe nuk i pengohej veprimtaria tregtare, atëherë madhësia dhe kufijtë konkretë të aseteve mund të mos përbënin shkak për cenimin e së drejtës së pronës dhe do të

mbetej potencialisht vetëm kohëzgjatja e vazhdimit të masës së sigurimit si shkak i cenimit të së drejtës së pronës.

12. Në çdo rast shkaqet e sipërpërmendura në këtë vendim pakice më rezultojnë të mjaftueshme që çështja të kalonte për shqyrtim në themel në seancë plenare për të zhvilluar një standard në nivel kushtetues lidhur me pasojat mbi të drejtën e pronës në rastin e një mase kufizuese sigurimi që ka një kohëzgjatje joproporcionale.

13. Për sa më lart, çmoj se në këtë rast Mbledhja e Gjyqtarëve do të duhej të kishte shqyrtuar pretendimin për cenimin e parimit të proporcionalitetit të lidhur me të drejtën e pronës së kërkueses në seancë plenare, për të shqyrtuar kohëzgjatjen e masës.

Anëtare: Marjana Semini